

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 25.8.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 119, DATË 23.4.2009 “PËR PLANIFIKIMIN
E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 92 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme :

1. Në shkronjën “b” të pikës 1, fjalët “... jo më vonë se data 1 shtator 2010 ...” zëvendësohen me “... jo më vonë se data 15 janar 2011 ...”.

2. Në pikën 3 fjalët “... në datën 1 shtator 2010 ...” zëvendësohen me “... në datën 15 janar 2011 ...”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha